

Siguri

Ekskluzive | Antidroga i gjen pistoletë në çantë 27-vjeçarit në Prishtinë – përfundon në burg për shkak të një urdhër-arrest aktiv



Sinjali.com

04 Gusht 2026 10:06



Një aksion i Njesisë së Antidrogës në Prishtinë ka çuar në zbulimin e një arme zjarri dhe dërgimin në burg të një 27-vjeçari, ndaj të cilit ishte në fuqi edhe një urdhër-arrest aktiv.

Sinjali mëson se bëhet fjalë për **Shpend A. Osmanin** rreth 27 vjeçar.

Sipas burimeve, rasti ka ndodhur mbrëmjen e 3 gushtit, rreth orës 23:30, në rrugën “Bashkim Fehmiu” në Prishtinë.

Gjatë një aksioni në terren, Njësia e Antidrogës ka ndaluar të dyshuarin dhe, gjatë kontrollit të çantës që mbante me vete, i është gjetur një pistoletë e tipit “Pietro Beretta”, kalibër 7.65 mm, së bashku me një karikator dhe një fishek të të njëjtit kalibër.

Në vendngjarje është kërkuar asistencë policore, ndërsa arma dhe municioni janë sekuestruar në cilësinë e provave materiale.

Pas intervistimit të të dyshuarit në prani të avokatit mbrojtës dhe konsultimit me Prokurorin e Shtetit, ndaj tij është iniciuar procedurë për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Gjatë verifikimeve, Policia ka konstatuar se Shpend Osmani kishte edhe një urdhër-arrest aktiv, për çka është dërguar në Qendrën e Paraburgimit për vuajtjen e një dënimi me 15 ditë burgim.

Hetimet lidhur me armën e sekuestruar janë në vazhdim.

Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!

/GazetaSinjali/

Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



Lajme

Zgjedhjet 2026
Kosovë
Shqipëri
Rajon
Diasporë
Evropë
Botë

Aktualitet

Politikë
Drejtësi
Siguri
Shëndetësi
Arsim
Sociale

Hulumtime

Ekskluzive
Profile
Skandaloze

Ekonomi

Prodhime Vendore
Financa
Biznes

Sport

Botërori 2026
Futboll
Basketboll
Sporte Luftarake
Sporte të tjera

Showbiz

Bota e Yjeve
Modë & Stil
Bukuri dhe kujdes
Të tjera

OP-ED

Analizë
Kolumne
Intervistë

Jetë

Fitnes
Ushqime
Travel
Këshilla
Receta
Dieta
Shëndeti

Kulturë

Film
Muzikë
TV & Radio
Libra
Art & Dizajn
Fotografi
Histori

Tech & Auto

Teknologji
Automjete
Telefona
Internet
Lojëra
Aplikacione

Fun

Qesharake
Kuriozitete
Kuize
Fakte
Të tjera